



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 606/7prot.

Tiranë, më 18.7.2025

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr.31, datë 18.7.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT
TË ECURISË DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE DHE PARALAJMËRIMIN E
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore ndaj nëpunëses Rudina Bollano, në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën nr. 606 prot., datë 12.6.2025, të dërguar nga nëpunësja Rudina Bollano, me detyrë “Drejtore të Drejtorisë së Ekzaminimit”, pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në të cilin ngrihen pretendimet e nëpunëses, për parregullsi të kryera në zbatimin e legjisllacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të saj.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, parashtrohet se, me aktin nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, të eprorit direkt “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses Rudina Bollano është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, për shkelje të klasifikuara në germën c), të pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në informacionin e dërguar, nëpunësja parashton se, në datën 9.6.2025, nga nëpunësja e protokollit i është komunikuar akti me nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, nga titullari i institucionit, i cili është njëkohësisht edhe eprori direkt i nëpunëses.

Nëpunësja pretendon se në përmbajtje të aktit për dhënien e masës disiplinore, nuk është cituar motivacioni për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, si dhe nuk është ndjekur procedura administrative e parashikuar për aplikimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore që normojnë këtë institut të ligjit.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e eprorit direkt, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nëpërmjet shkresës nr. 606/2 prot., datë 19.6.2025 “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja Rudina Bollano, për dhënie mase disiplinore “Vërejtje””, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure disiplinore, si dhe ka kërkuar dokumentacionin në të cilën është materializuar ky proces.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, me shkresën nr.2677/1 prot., datë 27.6.2025, me objekt: “Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 606/2 prot., datë 19.6.2025, protokolluar me tonën me nr.2677 prot., datë 20.6.2025”, e protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 606/3 prot., datë 30.6.2025, ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, si aktet e emërimit, aktin e deklarimit të statutit të nëpunëses R. Bollano, si dhe strukturën e institucionit të DPPI, duke cituar se, bashkëlidhur shkresës janë edhe materialet shkresore që lidhen me ecurinë disiplinore, por që në fakt, nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit të dërguar.

Në këto rrethana, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 606/4 prot., datë 8.7.2025 “Kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të dërguar me shkresën nr.2677/1 prot., datë 27.6.2025, nga DPPI, në lidhje me procedurën e ndjekur për dhënie mase disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses Rudina Bollano”, ka kërkuar që brenda afatit 3 ditor, të dërgohet dokumentacioni i plotë shkresor në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në ngarkim të nëpunëses R. Bollano, (nëse ka), me qëllim verifikimin e plotë të rastit.

Në kushtet kur, informacioni i kërkuar deri në datën 18.7.2025, në tejkallim të afatit të vendosur nga Komisioneri nuk është vënë në dispozicion, e për këtë arsye, inspektori i ngarkuar me verifikimin e këtij rasti, së bashku me Drejtorin e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, janë paraqitur pranë subjektit në fjalë, me qëllim administrimin e dokumentacionit të kërkuar, veprim që është dokumentuar nëpërmjet procesverbalit administrative nr. 606/5 prot., datë 18.7.2025, në prani të Përgjegjës së Sektorit të Buxhetit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, si përfaqësuese e njësisë përgjegjëse të institucionit.

Në momentin e paraqitjes së grupit të punës së Komisionerit në institucion, sipas procesverbalit të mbajtur, është sqaruar nga përfaqësuesja e njësisë përgjegjëse të institucionit se:

“.... dokumentacioni do të dërgohet me shkresë zyrtare pranë KMSHC, pas siglimit nga Drejtoresha e Përgjithshme e institucionit të DPPI, e cila aktualisht është me shërbim jashtë vendit”.

Gjithashtu, sa i takon kërkesës së grupit të punës, për të kqyrur dosjen në të cilën administrohet dokumentacioni i hartuar gjatë procedurës disiplinore, nga nëpunësja, u sqarua se:

“... dosja ndodhet vetëm në protokoll dhe nuk është depozituar në dosjen e personelit të nëpunës R. Bollano, pasi nuk është dorëzuar nga eprori i drejtpërdrejtë, i cili ka ndjekur procedurën disiplinore”.

Në këto kushte, grupit të punës nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion që ka lidhje me procedurën disiplinore, që është ndjekur në ngarkim të nëpunës Rudina Bollano.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri për këtë rast, rezulton se, me aktin nr.1323/18 prot., datë 24.12.2014, të njësisë përgjegjëse DAP, nëpunësja Rudina Bollano, është emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Patentave në Drejtorinë e Ekzaminimit, Koordinimit dhe Trajnimeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe i është deklaruar statusi i punësimit si “nëpunës civil” në të njëjtin pozicion.

Më tej, konstatohet se, nëpërmjet aktit nr. 5676 prot., datë 17.11.2015, korrigjuar me aktin nr. 5806 prot., datë 23.11.2015, të njësisë përgjegjëse DAP, nëpunësja në fjalë është emëruar në pozicionin “Drejtore”, në Drejtorinë e Ekzaminimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave.

Gjatë marrëdhënies së punës, rezulton se me aktin nr. 5902/11 prot., datë 10.9.2018 “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, të njësisë përgjegjëse DAP, është vendosur transferimi i përhershëm i saj, në pozicionin “Drejtore i Drejtorisë së Ekzaminimit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe së fundmi,

nëpërmjet aktit nr. 4857/1 prot., datë 6.9.2024 “*Transferim për shkak të risturkturimit të institucionit*”, të njësisë përgjegjëse DAP, është vendosur transferimi në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Ekzaminimit*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, pozicion të cilin mban aktualisht.

Sipas dokumentacionit që disponon Komisioneri, të paraqitur nga nëpunësja, rezulton se, me aktin nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, të eprorit direkt, që është znj. Maria Solis, në ngarkim të nëpunëses Rudina Bollano, është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje*”, për shkelje të lehtë të klasifikuar në germën c), të pikës 4, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Sa i takon ligjshmërisë së dhënies së kësaj mase disiplinore, vlerësojmë se duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Konkretisht, në nenin 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, parashikohen “*Llojet e masave disiplinore*” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

a) vërejtje;

b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

ç) largim nga shërbimi civil”,

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në germat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “*Organet Disiplinore*”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë: njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, e cituar në VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, i ndryshuar, në mënyrë edhe me të detajuar për secilën fazë të saj parashikohet në Udhëzimin nr. 1, datë 21.1.2025, të Departamentit të Administratës Publike “*Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet.

Në mbështetje të dokumentacionit të administruar për hetimin e këtij rasti, sa i takon aspektit procedural të ecurisë, konstatohet se, **nuk janë respektuar** kërkesat e parashikuara në pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument shkresor që të pasqyrojë veprimet administrative të kryera gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunëses, nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vlerësimit të shkeljes së pretenduar, vënies në dijeni me shkrim të nëpunëses, seancën dëgjimore, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për masën disiplinore, “*Vërejtje*” dhënë ndaj saj. Në këtë rast, i gjithë procesi është finalizuar me aktin nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, të titullarit, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, në ngarkim të nëpunëses Rudina Bollano.

Sa më lart, konstatohet se, akti nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, ka dalë nga Drejtor i Përgjithshëm, i institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, duke mos respektuar kërkesat e parashikuara në pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014, e si rrjedhim ky akt, në zbatim të germës a), ii), të nenit 108 “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*”, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i*

Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Më tej, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, parashikohet se, ky akt nuk sjell asnjë pasojë juridike, e në këto kushte, vetë organi publik, që në këtë rast përkon me Drejtorin e Përgjithshëm, të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, për dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, ndaj nëpunëses Rudina Bollano, si dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e dhënies së masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses.

Gjithashtu, gjatë hetimit të këtij rasti, konstatohet se, pas kërkesës për plotësimin e dokumentacionit, nëpërmjet shkresës nr. 606/4 prot., datë 8.7.2025, të Komisionerit, institucioni të cilit ajo i është drejtuar nuk është përgjigjur dhe ka ndërprerë bashkëpunimin, në shkelje të pikës 3, të nenit 14 “*Kompetencat*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “*Institucionet që punësojnë nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që kanë kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo kanë informacion në këtë fushë, kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Komisionerin.*”

Në këto rrethana, Komisioneri në mbështetje të kompetencave të tij ligjore, të parashikuara në nenet 11, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, i **tërheq vëmendjen** njësisë përgjegjëse të institucionit, si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për mungesë të korrektësisë në zbatimin e ligjit në kushtet e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; të neneve 108, 110 dhe 111 ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Drejtori i Përgjithshëm, i institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, duhet të

konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 2375 prot., datë 5.6.2025, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses Rudina Bollano dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses dhe nga Regjistri Qëndror i Personelit.

2. Njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësja Rudina Bollano.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha